

Mënyra e dytë:



 Mbushet plotësisht depozita me ujë të pastër.

 Shtohet lënda dezinfektuese sipas raportit 100 ml hipoklorit natriumi në 1000 litra ujë.

 Mbyllen valvulat e tubacioneve, mbyllet kapaku dhe përzierja lihet të qëndrojë në sistem për 24 orë. Nëse sasia e klorit të përdorur dyfishohet, koha e qëndrimit nga 24 orë behet 8 orë.

 Pas dezinfektimit, hapen të gjitha valvulat dhe shkarkohet depozita me ujë të përzier me tretësirë klori.

 Shpëlahet depozita dhe tubacionet me ujë të pastër dhe të bollshëm për të eliminuar të gjithë klorin e mbetur në to. Mbushja dhe zbrazja e saj nëpër tuba do të vazhdojë derisa në rubinet të mos ndihet era e klorit.

 Mbushet depozita me ujë të pijshëm të ujësjellësit.

 Mbyllet hermetikisht kapaku i depozitës. Për arsye sigurie, rekomandohet që kapaku të pajiset me dryn.

KUJDES:

Dezinfektimi i puseve



Puset e ujit, qofshin këto individuale apo kolektivë, kanë nevojë që të pastrohen dhe dezinfektohen, pasi mund të përbëjnë një burim të rëndësishëm ndotjeje dhe kontaminimi për komunitetin.

Dezinfektimi i puseve të ujit ndjek pothuajse të njëjtin parim sikurse edhe dezinfektimi i depozitave të ujit. Më poshtë përshkruhet me detaje mënyra se si bëhet pastrimi dhe dezinfektimi i puseve.

Fillimisht muret e puseve pastrohen dhe pastaj lahen me solucion klori që përmban 100 mg/l klor aktiv. Ky solucion përgatitet duke tretur rreth 40 g hipoklorit kalciumi (i ngurtë) i cili përmban 25% klor aktiv në 100 litra ujë. Pasi matet vëllimi i ujit në pus, hidhet solucionin duke llogaritur që përmbajtja e klorit aktiv të arrijë 50–100 mg/l dhe të ketë shpërndarje uniforme. Uji në pus lihet të qëndrojë në këtë gjendje rreth 12 orë dhe pastaj nxirret me pompë ose me kovë për t'u riqarkulluar.

**PASTRIMI I DEPOZITAVE ËSHTË PËRGJEGJËSI
INDIVIDUALE. ATO DUHET TË PASTROHEN RREGULLISHT
ÇDO VIT.**

DEPOZITAT DHE Puset E UJIT Si ti pastrojmë ato?





Në mungesë të ujit të rrjedhshëm 24 orë, shumë qytetarë përdorin në shtëpitë e tyre ujë që vjen nga depozitat personale. Për të shmangur rrezikun që mund të vijë nga uji i grumbulluar në këto pajisje, rekomandohet që depozitat të pastrohen rregullisht. Ky pastrim ka për qëllim që të heqë mbetjet e ngurta të cilat precipitojnë me kalimin e kohës në fund të depozitës si dhe të pastrojnë faqet e brendshme të pajisjes duke përdorur dezinfektantë kimikë.

Më poshtë paraqiten hapat që duhet të ndiqen për pastrimin e ujit të depozitave:



Pastroni mirë nga jashtë depozitën, duke e larë me ujë të rrjedhshëm dhe të bollshëm;



Mbyllni valvulat e tubacioneve;



Boshatisni plotësisht depozitën e ujit;



Zhvendosni të gjitha mbetjet që kanë precipituar në fund të pajisjes, duke përdorur doreza;



Pastroni faqet e brendshme të depozitës së ujit duke përdorur një furçë dhe pastaj sfungjer, në mënyrë që të garantoher një pastrim sa më i plotë i pajisjes nga brenda;



Shpëlani me ujë të rrjedhshëm me presion faqet e brendshme të depozitës, derisa të pastrohen plotësisht;



Dezinfektoni sipërfaqen e brendshme të depozitës, sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Si bëhet dezinfektimi i sipërfaqes së brendshme të depozitave?



Pasi është pastruar nga brenda depozita, bëhet dezinfektimi i sipërfaqes së brendshme të saj sipas njërës prej dy mënyrave të mëposhtme:

Mënyra e parë:



Përgatitet tretësira dezinfektuese duke përdorur hipoklorit natriumi të lëngët (NaOCl) me përqendrim 12.5% klor aktiv në raportin: 200 ml NaOCl në 1 litër ujë. Tretësirën e përfutur e vendosim në një enë që të ketë pompë spërkatëse.

Me një furçë të re spërkatet e gjithë sipërfaqja e brendshme e depozitës me këtë tretësirë dezinfektuese dhe lihet të qëndrojë për të paktën 30 - 60 minuta. Rekomandohet që ky veprim të bëhet para orarit të furnizimit me ujë të pijshëm nga rrjeti shpërndarës i ujësjellësit.

Shpëlahet depozita me ujë të pastër dhe të bollshëm për të eliminuar të gjithë përzierjen e klorit të mbetur në të.

Mbushet depozita me ujë të pijshëm të ujësjellësit.

Mbyllet hermetikisht me kapak depozita